



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.120

24 gusht

2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.585, datë 24.8.2011	Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me përfaqësues në Ekipin Operacional të Patronazhit dhe Koordinimit Policor (POMLT) të vendeve të Kartës së Adriatikut, në operacionin ushtarak “ISAF”, Afganistan.....	4743
Udhëzim i METE nr.5380, datë 20.7.2011	Për procedurat e shitjes me ankand publik të aseteve të shoqërive anonime me kapital shtetëror në likuidim.....	4744
Udhëzim i MF nr.18, datë 23.8.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.26, datë 4.9.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar.....	4747
Vendim i ERE nr.62, datë 22.7.2011	Për miratimin e kontratës tip për shërbimin e verifikimit, kontrollit fillestar dhe periodik të matësve të energjisë elektrike...	4753

VENDIM
Nr.585, datë 24.8.2011

PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME PËRFAQËSUES NË EKIPIN OPERACIONAL TË PATRONAZHIT DHE KOORDINIMIT POLICOR (POMLT) TË VENDEVE TË KARTËS SË ADRIATIKUT, NË OPERACIONIN USHTARAK "ISAF", AFGANISTAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 5, e 7 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", të ndryshuar, të pikave 6 e 11 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin e një përfaqësuesi ushtarak në Ekipin Operacional të Patronazhit dhe Koordinimit Policor (POMLT) të vendeve të Kartës së Adriatikut, të drejtuar nga Kroacia, në kuadër të operacionit ushtarak "ISAF" Afganistan.

2. Autoriteti i drejtimit operacional për përfaqësuesin e Policisë Ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për kohën e qëndrimit në mision, është Komanda Rajonale Qendrore "ISAF" në Kabul, Afganistan.

3. Misioni i përfaqësuesit të Policisë Ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Ekipin Operacional të Patronazhit dhe Koordinimit Policor (POMLT) të vendeve të Kartës së Adriatikut, të drejtuar nga Kroacia, në kuadër të operacionit ushtarak "ISAF" në Afganistan, është:

a) Marrja në patronazh për trajnimin, drejtimin, mbështetjen dhe zhvillimin operacional të Shkollës së Policisë Ushtarake të Ushtrisë Kombëtare Afgane (SHPUUKA) në Kabul, Afganistan, dhe krijimi i bazave për koordinimin, komandimin/kontrollin dhe kryerjen e planzimeve në operacion;

b) Pjesëmarrja në kryerjen e operacioneve luftarake dhe mbështetëse për plotësimin e misionit të Shkollës së Policisë Ushtarake të Ushtrisë Kombëtare Afgane (SHPUUKA), në qytetin e Kabulit, rrethinat e tij, si dhe zonën e operacioneve (ZO), e cila mund t'i jepet kësaj shkolle në patronazh nga NATO-ja, me qëllim zhvillimin e një force të aftë, kompetente dhe profesionale për dhënien e kontributit dhe sigurisë së mirëqeverisjes së popullsisë afgane në Kabul apo rrethinat e tij.

4. Kohëzgjatja e këtij misioni është 2 (dy) vjet, afat, i cili fillon të llogaritet nga data e dërgimit të përfaqësuesit ushtarak në Afganistan. Kohëzgjatja për çdo rotacion është 6 (gjashtë) muaj.

5. Ministria e Mbrojtjes të përballojë, për përfaqësuesin ushtarak pjesëmarrës në këtë operacion, shpenzimet për:

a) shpërblimin për vështirësi shërbimi, në masën 9 000 (nëntë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) akomodim, ushqim;

ç) ekologji (pastrim, higjienë);

d) trajtim mjekësor;

dh) ujë të pijshëm;

e) shërbim telefonik celular;

ë) transportimin e individit të shkëputur të misionit për në atdhe, për raste vdekjesh, sëmundjesh dhe thyerje disipline;

f) transport strategjik;

g) shpenzime për trajnimin para dislokimit;

gj) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit;

h) rehabilitim pas misionit.

6. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet në grup të ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që do të marrë pjesë në këtë mision.

7. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

8. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

UDHËZIM

Nr.5380, datë 20.7.2011

PËR PROCEDURAT E SHITJES ME ANKAND PUBLIK TË ASETVE TË SHOQËRIVE ANONIME ME KAPITAL SHTETËROR NË LIKUIDIM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, të ligjit nr.9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik” dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.428, datë 9.6.2010, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

UDHËZON:

1. Me shpalljen e shoqërisë në likuidim, procedurat bëhen në përputhje me nenet 190 deri në 203 të pjesës VI “Likuidimi në gjendjen e aftësisë paguese”, të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

2. Operacionet e likuidimit kryhen nga likuidatori, i cili përfaqëson shoqërinë dhe ka për objekt mbylljen e llogarive dhe çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

3. Me kalimin e shoqërisë në likuidim, hartohet bilanci i likuidimit, i cili verifikohet dhe vërtetohet nga eksperti kontabël i autorizuar. Bilanci, për efekt likuidimi, miratohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shërben si pikënisje për identifikimin e asetve, elemente të pasurisë që do të likuidohet. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë, të cilat verifikohen dhe vërtetohen nga eksperti kontabël i autorizuar dhe miratohen nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

4. Me shpalljen e shoqërisë në likuidim, pasuritë e luajshme dhe të paluajshme, shiten nëpërmjet ankandit publik. Në zbatim të pikës 5, germa “b” dhe të pikës 5.1, germa “a” të kreut V të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1719, datë 17.12.2008, autoriteti shitës ngre njësinë e ankandit, e cila do merret me hartimin e dokumentacionit të ankandit, kërkesat për kualifikim, kriteret e vlerësimit etj., për hartimin e të cilave duhen përdorur dokumentet standarde të ankandit. Gjatë procesit të hartimit të dokumenteve duhet të mbahet procesverbali, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e njësisë së ankandit, njësia e ankandit mban përgjegjësi për hartimin e dokumenteve të ankandit në bazë të legjislacionit në fuqi. Njoftimi për shitje bëhet katër herë radhazi në Buletinin e Njoftimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, nga data e dërgimit të njoftimit për shitje, si dhe afishohet edhe në mjediset e shoqërisë e në objektin që do të shitet. Njoftimi në Agjencinë e Prokurimit Publik bëhet dhe ndiqet nga autoriteti shitës, i cili bën dhe dorëzimin e dokumenteve standarde të ankandit të shpallur kandidatëve blerës kundrejt një pagese të përcaktuar në njoftimin për ankand.

5. Ankandet për shitjen e pasurive të ndërmarrjeve dhe shoqërive tregtare shtetërore në likuidim bëhen në mjediset e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

6. Njësia e ankandit përbëhet nga jo më pak se 3 veta, ku njëri prej tyre duhet të jetë jurist dhe të mbajë përgjegjësi për shqyrtimin e ofertave. Një nga anëtarët e njësisë së ankandit caktohet me autorizim të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, mbi bazën e kërkesës së likuidatorit të shoqërisë, si përfaqësues i pronarit shtet.

Në rast se në ditën e njoftuar për zhvillimin e ankandit nuk paraqitet njëri nga anëtarët e njësisë së ankandit, anëtarët e tjerë të pranishëm të njësisë së ankandit administrojnë kërkesat e paraqitura për blerje dhe njësia ankandit njofton një ditë tjetër për zhvillimin e ankandit, por jo më shumë se 10 (dhjetë) ditë nga data e parë e njoftuar për ankand.

Që të fillojë procesi i përzgjedhjes së fituesit, para njësisë së ankandit, duhet të paraqiten të paktën 2 (dy) kërkesa dhe, që të vazhdojë procesi në vijim të procedurës së hapur, duhet të paktën 1(një) ofertë e vlefshme.

7. Bazuar në kreun III, pika 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.428, datë 9.6.2010 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, në ankandet për shitjen e pasurive të këtyre shoqërive nuk zbatohet, për ish-pronarët, e drejta e parablerjes. Ata marrin pjesë në ankand si të gjithë të tjerët. Në rastet e shpalljes fitues, ish-pronarëve u zbritet vlera e truallit, e njohur dhe e kthyer me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

8. Gjatë zhvillimit të ankandit mbahet procesverbal, ku evidentohen emrat e anëtarëve të njësisë së ankandit, emrat e konkurruesve në ankand dhe emri i personit të shpallur fitues. Fituesi lidh kontratë për blerjen e objektit, pas pagesës së plotë të vlerës së objektit, përfshirë dhe TVSH-në (20%) për asetet, që janë objekt i saj. Pagesa në asnjë rast nuk mund të bëhet me letra me vlerë ose bono privatizimi. Me lidhjen e kontratës, likuidatori bën dorëzimin e objektit, nëpërmjet aktit të dorëzimit.

9. Nëse personi, që ka fituar të drejtën e blerjes së objektit nuk paguan brenda 30 ditëve nga data e shpalljes fitues, vlerën e çmimit të arritur në ankand, ai e humbet të drejtën e blerjes, i konfiskohet sigurimi i ofertës, si dhe humbet të drejtën për të marrë pjesë në ankandin, që do të zhvillohet për rishitjen e këtij objekti. Objekti rishpallet për shitje, duke zbatuar procedurat e publikimit, sipas përcaktimeve në këtë udhëzim.

10. Për përcaktimin e vlerës fillestare të ankandit publik, ngrihet komision i posaçëm vlerësimi pranë autoritetit shitës, i cili përgatit dokumentacionin për vlerësimin e objektit të caktuar për shitje. Vlera fillestare e ankandit për shitjen (VAM) është vlera e objektit në përputhje me çmimet e tregut të përcaktuar nga eksperti vlerësues, vlera e truallit e përcaktuar nga eksperti vlerësues në bazë të çmimit të përcaktuar në hartën e çmimeve, të hartuar nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, duke i shtuar vlerën sipas vlerësimit të komisionit të materialeve të tjera të objektit përkatës. Ekspertët vlerësues emërohen nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës me kërkesën e likuidatorit të shoqërisë. Akti i vlerësimit për objektet duhet të ketë bashkëngjitur gentplanin të hartuar nga ekspertë të licencuar dhe të konfirmuar nga institucioni i prefektit, fotografi të pronës, vendndodhjen dhe dokumentacionin e pronësisë.

11. Me hartimin e gentplanit nga eksperti vlerësues dhe të konfirmuar nga institucioni i prefektit, në territorin në të cilin ndodhen objektet, shoqëria kërkon në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, hartën treguese dhe kartelën e pronësisë së objektit, që do të shitet e rifreskuar, e cila do t'i bashkëngjitet raportit të vlerësimit. Brenda 20 ditëve të dorëzimit të raportit të vlerësimit të ekspertit, likuidatori i shoqërisë, kur nuk ka kundërshtime, e dërgon atë në METE për miratim.

12. Vlera fillestare e ankandit (VAM) për makineritë e pajisjet mjetet e transportit, produktet dhe skrapit, është vlera e përcaktuar nga ekspertët vlerësues. Ekspertët vlerësues emërohen nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës me kërkesën e likuidatorit të shoqërisë.

13. Bazuar në kreun I, pika 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.428, datë 9.6.2010 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, pagesa e ekspertit vlerësues do të jetë 2 për qind e vlerës së objektit apo të grupobjekteve të vlerësuara, por jo më pak se 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë dhe jo më shumë se 300 000

(treqind mijë) lekë. Kjo procedurë pagese do të ndiqet për çdo vlerësim që do të bëhet me ekspert vlerësues.

14. Për vlerësimin e materialeve, të objekteve të inventarit dhe sendeve të tjera, likuidatori ngre një komision të posaçëm, për vlerësimin e të cilave komisioni bazohet në çmimin e tregut ose në vlerën fillestare sipas kontabilitetit, nëse shihet e arsyeshme nga komisioni.

15. Për metalet me ngjyrë, si: bakri, alumini, plumbi, zinku, kallaji, nikeli, ari dhe argjendi, vlera fillestare e ankandit përcaktohet nga ekspertë vlerësues, duke iu referuar në llogaritje çmimit përkatës sipas Bursës së Londrës (LME).

16. Raportet e vlerësimit të ekspertit vlerësues, si dhe raportet e komisionit miratohen para publikimit nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

17. Në rast se nuk realizohet shitja me vlerat e përcaktuara nga ekspertët vlerësues, pas shpalljes dy herë për shitje, objekti publikohet për herë të tretë, me një ulje VAM-i me 30 për qind të vlerës fillestare të objektit, duke i shtuar kësaj vlere edhe vlerën e truallit, të përcaktuar nga ekspertët vlerësues. Nëse edhe me këtë vlerë nuk shitet, atëherë për përcaktimin e destinacionit të mëtejshëm të objektit vendos Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Për të gjitha rastet e tjera të shitjes, me anë të procedurës me ankand publik, nuk realizohet shitja me vlerat e përcaktuara nga ekspertët vlerësues, ose komisioni i ngritur nga likuidatori pas shpalljes dy herë për shitje, publikohet për herë të tretë, me një ulje VAM-i me 30 për qind të vlerës fillestare.

18. Për të gjitha rastet që janë kryer të gjitha procedurat e shitjes dhe nuk ka blerës, të kryhen procedurat e nxjerrjes, jashtë përdorimit sipas legjislacionit në fuqi.

19. Për të gjitha rastet e nxjerrjes jashtë përdorimit, ngrihet komisioni nga autoriteti shitës, duke zbatuar të gjitha procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit, në zbatim të legjislacionit në fuqi. Nga likuidatori i shoqërisë plotësohet dosja e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe së bashku me miratimin e Këshillit Mbikëqyrës dërgohet në Ministri për të marrë miratimin e Ministrisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

20. Të ardhurat e realizuara nga likuidimi, si: shitja e aseteve, arkëtimi i debitorëve, të ardhurat nga qiraja apo dhe fitime të tjera, shërbejnë për shlyerjen e kreditorëve të shoqërisë në likuidim, në mënyrë proporcionale në varësi të mjeteve monetare të siguruara. Përfshihen nga ky rregull detyrimet fiskale dhe ato sociale (paga dhe sigurime shoqërore), të cilat do të shlyhen tërësisht, sipas detyrimeve të pasqyruara në bilancin kontabël të miratuar nga organet kompetente. Për kërkesat debitorë, të paarkëtueshme, si në rastin kur debitorët nuk ekzistojnë, kur kërkesat nuk janë të dokumentuara apo është humbur procesi gjyqësor etj., procedohet duke i kaluar si shpenzime likuidimi.

21. Rregullave të ankandit publik në bazë të legjislacionit në fuqi duhet t'u nënshtrohen edhe ndërmarrjet të shpallura të falimentuara në rrugë administrative për shitjen e mjeteve të xhiros, makineritë e pajisjet, linjat e repartit e nxjerra jashtë përdorimit dhe zbatimit të procedurave të demolimit.

22. Në publikimin për shitje të pasurisë së shoqërisë në likuidim përfshihen edhe objektet e dhëna me qira, përpara datës së shpalljes së shoqërisë në likuidim.

23. Llogaritë vjetore depozitohen në formën dhe në afatet e parashikuara në ligjin nr.9228, datë 29.4.2008 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

24. Anulohen të gjitha miratimet e privatizimit të aseteve të përfshira në kapitalin e shoqërisë që nuk kanë filluar procedurën e përgatitjes së dokumentacionit para datës së shpalljes së shoqërisë në likuidim me vendim gjyqi.

25. Udhëzimi nr.317/1, datë 4.9.2009 "Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit publik", shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Nasip Naço

UDHËZIM
Nr.18, datë 23.8.2011

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.26, DATË 4.9.2008
“PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.26, datë 4.9.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Pika 2.2. “Taksa vjetore e qarkullimit rrugor të mjeteve” ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“2.2. Taksa e qarkullimit për benzinën dhe gazoilin

Taksa e qarkullimit për benzinën aplikohet për produktet sipas kodeve tarifore të NKM-së 2710 11 41, 2710 11 45, 2710 11 49, 2710 11 51, 2710 11 59 dhe për gazoilin, sipas kodeve tarifore 2710 19 31, 2710 19 35, 2710 19 41, 2710 19 45, 2710 19 49.

Taksa e qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin është 5 lekë litri deri në 31.12.2011, pas kësaj date, taksa e qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin bëhet 7 lekë litri. Kjo taksë zbatohet si për benzinën e gazoilin e importuar, ashtu edhe për atë të prodhuar në vend.

Për benzinën dhe gazoilin e importuar, importuesi e paguan taksën e qarkullimit pranë degëve doganore ku është duke kryer procedurat e zhdoganimit.

Për benzinën dhe gazoilin e prodhuar, prodhuesi paguan në bankën e nivelit të dytë për llogari të drejtorisë rajonale ku është regjistruar, taksën për të gjithë sasinë e prodhuar, brenda datës 5 të muajit pasardhës. Prodhuesi duhet të plotësojë e dorëzojë në drejtorinë rajonale tatimore ku është regjistruar, formularin nr.1, si bashkëlidhur, duke deklaruar sasinë e prodhuar dhe duke i bashkëlidhur mandatpagesën për taksën e paguar.”.

Pika 2.3.1 “Taksa e mjeteve të përdorura të transportit”, ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“2.3.1. Taksa e mjeteve të përdorura të transportit caktohet sipas formulës:

Cilindrata në cm³ x koeficienti fiks sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit.

Taksa fikse për llojin e karburantit është 25 lekë për naftën dhe 20 lekë për benzinën.

Koeficienti sipas vjetërsisë së mjetit është si në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Mjetet me vjetërsi nga 0-3 vjet nuk janë subjekt i kësaj takse.

“Viti i vjetërsisë” është diferenca ndërmjet vitit, kur mjeti kryen pagesën e taksës me vitin e prodhimit.

Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, nëpërmjet drejtorive rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Për mjetet, që regjistrohen për herë të parë, taksa llogaritet proporcionalisht për periudhën e mbetur të vitit. 18% e të ardhurave vjetore nga kjo taksë i kalojnë buxhetit të qeverisjes vendore në bazë të procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pagesa e taksës bëhet në çdo kohë, por gjithnjë para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Vlera e taksës është vjetore (për vitin kalendarik në të cilin arkëtohet) pavarësisht nga momenti në të cilin ajo paguhet.

Shembuj. Tabela e mëposhtme përmbledh masën e taksës që paguan një automjet, në bazë të cilindratës, vitit të vjetërsisë dhe llojit të karburantit që përdor, naftë apo benzinë.

AUTOVETURA
Naftë

viti vjetërsisë/cilindrata	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1200	5,400	5,700	6,000	6,300	6,600	6,900	7,200	8,400	9,600	10,800	12,000	13,200	14,400	15,600
1300	5,850	6,175	6,500	6,825	7,150	7,475	7,800	9,100	10,400	11,700	13,000	14,300	15,600	16,900
1400	6,300	6,650	7,000	7,350	7,700	8,050	8,400	9,800	11,200	12,600	14,000	15,400	16,800	18,200
1500	6,750	7,125	7,500	7,875	8,250	8,625	9,000	10,500	12,000	13,500	15,000	16,500	18,000	19,500
1600	7,200	7,600	8,000	8,400	8,800	9,200	9,600	11,200	12,800	14,400	16,000	17,600	19,200	20,800
1700	7,650	8,075	8,500	8,925	9,350	9,775	10,200	11,900	13,600	15,300	17,000	18,700	20,400	22,100
1800	8,100	8,550	9,000	9,450	9,900	10,350	10,800	12,600	14,400	16,200	18,000	19,800	21,600	23,400
1900	8,550	9,025	9,500	9,975	10,450	10,925	11,400	13,300	15,200	17,100	19,000	20,900	22,800	24,700
2000	9,000	9,500	10,000	10,500	11,000	11,500	12,000	14,000	16,000	18,000	20,000	22,000	24,000	26,000
2100	9,450	9,975	10,500	11,025	11,550	12,075	12,600	14,700	16,800	18,900	21,000	23,100	25,200	27,300
2200	9,900	10,450	11,000	11,550	12,100	12,650	13,200	15,400	17,600	19,800	22,000	24,200	26,400	28,600
2300	10,350	10,925	11,500	12,075	12,650	13,225	13,800	16,100	18,400	20,700	23,000	25,300	27,600	29,900
2400	10,800	11,400	12,000	12,600	13,200	13,800	14,400	16,800	19,200	21,600	24,000	26,400	28,800	31,200
2500	11,250	11,875	12,500	13,125	13,750	14,375	15,000	17,500	20,000	22,500	25,000	27,500	30,000	32,500
2600	11,700	12,350	13,000	13,650	14,300	14,950	15,600	18,200	20,800	23,400	26,000	28,600	31,200	33,800
2700	12,150	12,825	13,500	14,175	14,850	15,525	16,200	18,900	21,600	24,300	27,000	29,700	32,400	35,100
2800	12,600	13,300	14,000	14,700	15,400	16,100	16,800	19,600	22,400	25,200	28,000	30,800	33,600	36,400

Benzinë

Viti vjetërsisë/cilindrata	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1200	4,320	4,560	4,800	5,040	5,280	5,520	5,760	6,720	7,680	8,640	9,600	10,560	11,520	12,480
1300	4,680	4,940	5,200	5,460	5,720	5,980	6,240	7,280	8,320	9,360	10,400	11,440	12,480	13,520
1400	5,040	5,320	5,600	5,880	6,160	6,440	6,720	7,840	8,960	10,080	11,200	12,320	13,440	14,560
1500	5,400	5,700	6,000	6,300	6,600	6,900	7,200	8,400	9,600	10,800	12,000	13,200	14,400	15,600
1600	5,760	6,080	6,400	6,720	7,040	7,360	7,680	8,960	10,240	11,520	12,800	14,080	15,360	16,640
1700	6,120	6,460	6,800	7,140	7,480	7,820	8,160	9,520	10,880	12,240	13,600	14,960	16,320	17,680
1800	6,480	6,840	7,200	7,560	7,920	8,280	8,640	10,080	11,520	12,960	14,400	15,840	17,280	18,720
1900	6,840	7,220	7,600	7,980	8,360	8,740	9,120	10,640	12,160	13,680	15,200	16,720	18,240	19,760
2000	7,200	7,600	8,000	8,400	8,800	9,200	9,600	11,200	12,800	14,400	16,000	17,600	19,200	20,800
2100	7,560	7,980	8,400	8,820	9,240	9,660	10,080	11,760	13,440	15,120	16,800	18,480	20,160	21,840
2200	7,920	8,360	8,800	9,240	9,680	10,120	10,560	12,320	14,080	15,840	17,600	19,360	21,120	22,880
2400	8,640	9,120	9,600	10,080	10,560	11,040	11,520	13,440	15,360	17,280	19,200	21,120	23,040	24,960
2500	9,000	9,500	10,000	10,500	11,000	11,500	12,000	14,000	16,000	18,000	20,000	22,000	24,000	26,000
2600	9,360	9,880	10,400	10,920	11,440	11,960	12,480	14,560	16,640	18,720	20,800	22,880	24,960	27,040
2700	9,720	10,260	10,800	11,340	11,880	12,420	12,960	15,120	17,280	19,440	21,600	23,760	25,920	28,080
2800	10,080	10,640	11,200	11,760	12,320	12,880	13,440	15,680	17,920	20,160	22,400	24,640	26,880	29,120

Shënim. Në bazë të shtojcës nr.1 të ligjit nr.10 458, datë 29. 7. 2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, pas vitit të 24-t të përdorimit, për autoveturat, koeficienti rritet me 0.04.

Mjetet që regjistrohen për herë të parë, në momentin e targimit të tyre, paguajnë vlerën e taksës në raport me kohën e hyrjes në qarkullim në territorin e Shqipërisë. Në rast se mjeti targohet në muajin janar, taksa paguhet e plotë, ndërsa për periudhën në vazhdim taksa paguhet në raport me muajt e hyrjes në qarkullim, pavarësisht datës së muajit.

Në rast se një mjet targohet për herë të parë pas muajit janar, vlera e taksës së mjeteve të përdorura është e barabartë me vlerën e taksës sipas formulës, pjesëtuar me 12 dhe shumëzuar me numrin e muajve të mbetur nga viti kalendar, që janë muajt në përdorim.

Shembull. Në rast se një autoveturë me cilindrata 2100 cm³, që punon me benzinë, me vite vjetërsie 11 vite, targohet për herë të parë në muajin maj, vlera e taksës së mjeteve të përdorura është e barabartë me vlerën e taksës sipas formulës, pjesëtuar me 12 dhe shumëzuar me 8 që janë muajt në përdorim.

Taksa e mjeteve të përdorura është: $2100 \times 20 \times 0.28 = 11,760$ lekë. Mjeti do të përdoret për 8 muajt e mbetur të vitit. Për këtë arsye, pronari i mjetit do të paguajë taksën në shumën $(11760/12) \times 8 = 7,840$ lekë.

Pagesa e kësaj takse shoqërohet me faturë dhe me pullën e taksës. Zotëruesi i mjetit e vendos pullën e taksës në xhamin e përparmë të mjetit për të lehtësuar ushtrimin e kontrollit vizual nga organet kompetente. Këto dokumente prodhohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe shpenzimet përballohen nga ky institucion në zbatim të nenit 8, pika 3, shkronja "c" të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar. Dokumentet e mësipërme duhet të përmbajnë elemente të sigurisë së lartë, për të shmangur falsifikimin e tyre. drejtoritë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor bëjnë regjistrimin ditor të arkëtimit të taksës, që shërben si dokument bazë për rakordimin e pagesës së taksës me organet e tatimeve.

Regjistrimi bëhet në një regjistër të veçantë ose në mënyrë elektronike, forma dhe përmbajtja e të cilit janë sipas formularit nr.2, bashkëngjitur këtij udhëzimi. Këto drejtori, brenda datës 31 janar të çdo viti, dërgojnë në drejtoritë rajonale të tatimeve dhe në strukturat e Ministrisë së Brendshme listën e mjeteve që nuk kanë paguar taksën për vitin paraardhës, si dhe listën e mjeteve të regjistruara. Personat fizikë apo juridikë, pronarë të këtyre mjeteve, në këto lista do të trajtohen si debitorë dhe nga ana e DPSHTRR-së dhe ndaj tyre do të fillojë të zbatohen masat shtrënguese.

Në rastet e mjeteve të cilat ndërrojnë pronësinë, drejtoritë rajonale të DPSHTRR-së nuk procedojnë me regjistrimin e pronësisë së mjetit në rast se për atë mjet nuk janë paguar taksat respektive.

Për mjetet që dalin përfundimisht nga qarkullimi, në momentin e paraqitjes së qytetarit për çregjistrimin e përhershëm, llogaritja për vlerën e taksës do të jetë e barabartë në raport me periudhën, që mjeti ka qenë në qarkullim.

Pas datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr.10 458, datë 29.7.2011 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, të gjitha mjetet që për vitin 2011 nuk kanë paguar taksën vjetore të qarkullimit dhe taksën e regjistrimit të përvitshëm, do të paguajnë taksën vjetore të mjeteve të përdorura, pavarësisht kur e kanë pasur datën e pagesës së taksave. Vetëm për vitin 2011, mjetet që do të paguajnë taksën vjetore të mjeteve të përdorura do të pajisen me pullën e taksës së qarkullimit, aktualisht në përdorim nga DPSHTRR-ja."

Pika 2.3.2 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

"Taksa e karbonit aplikohet për benzinën (sipas kodeve tarifore të NKM-së 2710 11 41, 2710 11 45, 2710 11 49, 2710 11 51, 2710 11 59), për gazoilin (sipas kodeve tarifore 2710 19 31, 2710 19 35, 2710 19 41, 2710 19 45, 2710 19 49), për qymyrin, me krerë tariforë të NKM-së 2701 dhe 2702, për vajgurin sipas kodeve tarifore (sipas kodeve tarifore 27 10 19 11 deri 27 10 19 29), për solarin (sipas kodit tarifor 2710 19 61), për mazutin (sipas kodeve tarifore të NKM-së 27101963, 27101965 dhe 27101969) dhe për koks naftë (sipas krerëve tariforë të NKM-së 2713 11 00 dhe 2713 12 00).

Taksa e karbonit caktohet në masën 1.5 lekë për litër për benzinën, 3 lekë për litër për gazoilin, 3 lekë për kilogram për qymyrin, 3 lekë për litër për solarin, 3 lekë/litri për mazutin, 3 lekë për litër për vajgurin dhe 3 lekë për kilogram për koks naftë.

Kjo taksë zbatohet si për benzinën, gazoilin, qymyrin, vajgurin, solarin, mazutin dhe koks naftë e importuar, ashtu edhe për ato të prodhuara në vend.

Për benzinën, gazoilin, qymyrin, vajgurin, solarin, mazutin dhe koks naftë e importuar, importuesi në momentin e importimit paguan taksën e karbonit, pranë degëve doganore ku kryhen procedurat e zhdoganimit.

Për benzinën, gazoilin, qymyrin, vajgurin, solarin, mazutin dhe koks naftë e prodhuar, prodhuesit llogaritin dhe deklarojnë detyrimin për taksën e karbonit në degën përkatëse të tatimeve në bazë të sasive të prodhuara të këtyre produkteve. Shumat e paguara nga kjo taksë derdhen brenda datës 5 të muajit pasardhës në bankën e nivelit të dytë për llogari të drejtorisë rajonale ku subjekti është regjistruar. Prodhuesi duhet të plotësojë e dorëzojë në drejtorinë rajonale tatimore ku është regjistruar, formularin nr.3, si bashkëlidhur, duke deklaruar sasinë e prodhuar dhe duke i bashkëlidhur mandatpagesën për taksën e paguar.”.

Pika 3.1. e udhëzimit ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“3.1. Përjashtohen nga pagimi i taksës vjetore të mjeteve të përdorura:

a) mjetet në pronësi të ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare, që gëzojnë status diplomatik, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar parimin e reciprocitetit;

b) personat fizikë ose juridikë, të cilët deklarojnë, brenda muajit janar të vitit në vazhdim, se nuk do të qarkullojnë me mjetet në pronësi të tyre gjatë këtij viti kalendarik, ose do të dalin përfundimisht nga qarkullimi dhe dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor targën dhe lejen e qarkullimit të mjetit;

b.1) pagesat e taksës së mjeteve të bllokuara me vendim të gjykatës, prokurorisë etj., për periudhën në të cilën mjete ka qenë i bllokuar.

c) autoveturat tip 4+1 vende dhe me cilindrata jo më shumë se 2500 kubikë, kur këto mjete kalojnë në zotërim të invalidëve e të veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidëve të punës, të verbërve, invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë që e fitojnë këtë status në bazë të ligjeve përkatëse dhe përdoren vetëm për nevojat e tyre personale dhe jo për veprimtari private.

Përjashtimi nga pagimi i taksës bëhet vetëm kur veprimet bëhen në emër të veteranit të luftës, invalidit të punës a të luftës, të verbrit, të sëmurëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Veterani i luftës, invalidi i luftës apo i punës, personat e verbër, si dhe të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë duhet të paraqesin pranë agjentit tatimor librezën përkatëse, së bashku me dokumentin e identifikimit të personit që përfiton përjashtimin nga taksa dhe vërtetimin që nuk kryen veprimtari ekonomike.

d) makinat bujqësore.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

Formulari nr.1

TABELA DEKLARUESE E PRODHIMIT
(për llogaritjen e taksës së qarkullimit)

Emri tregtar i subjekti prodhues shqiptar: _____

NIPT-i: _____

Adresa : _____

Nr. i telefonit: _____

Nr.	Lloji i lëndës djegëse për muajin ____	Njësia	Periudha mujore e prodhimit		Sasia e prodhuar	Taksa për njësi	Detyrimi lekë për t'u paguar
			nga data /	në datën /			
a	b	c	d	e	1	2	3=(1x2)
1	Benzinë	litër					
2	Gazoil	litër					

Subjekti deklarues
(Emër, mbiemër, firmë)

Data e deklarimit
____/____/201__

Shënim. Kjo tabelë dorëzohet nga tatimpaguesi prodhues brenda datës 5 të muajit pasardhës, në Drejtorinë Rajonale Tatimore ku është i regjistruar, shoqëruar me dokumentin e pagesës. Formulari plotësohet në dy kopje. Një kopje e mban Drejtoria Rajonale Tatimore dhe kopjen tjetër tatimpaguesi.

Formulari nr.2

REGJISTRI DITOR I TAKSËS VJETORE TË MJETEVE TË PËRDORURA
PËR VITIN

Muaji _____

Nr.	Numri i		Data	Emri, mbiemri i pronarit	Targa	Lloji i mjetit	Vlera e taksës (në lekë)	Numri i grupimit të mjetit (sipas faturës)
	Faturës	Mandat arkëtimi						

Drejtoria Rajonale e Transportit Rrugor

Formulari nr.3

TABELA DEKLARUESE E PRODHIMIT
(për llogaritjen e taksës së karbonit)

Emri tregtar i subjekti prodhues shqiptar _____

NIPT-i: _____

Adresa: _____

Nr. i telefonit: _____

Nr.	Lloji i lëndës djegëse për muajin	Njësia	Periudha mujore e prodhimit		Sasia e prodhuar	Taksa për njësi	Detyrimi lekë për t'u paguar
			nga data /	në datën /			
a	b	c	d	e	1	2	3 = (1x2)
1	Benzinë	litër				1,5	
2	Gazoil	litër				3	
3	Solar	litër				3	
4	Mazut	litër				3	
5	Koks nafte	kg				3	
6	Qymyr	kg				3	

Subjekti deklarues
(Emër, mbiemër, firmë)

Data e deklarimit
____/____/201

Shënim. Kjo tabelë dorëzohet nga tatimpaguesi prodhues brenda datës 5 të muajit pasardhës, në Drejtorinë Rajonale Tatimore ku është i regjistruar, shoqëruar me dokumentin e pagesës. Formulari plotësohet në dy kopje. Një kopje e mban Drejtoria Rajonale Tatimore dhe kopjen tjetër tatimpaguesi.

VENDIM
Nr.62, datë 22.7.2011

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS TIP PËR SHËRBIMIN E VERIFIKIMIT,
KONTROLLIT FILLESTAR DHE PERIODIK TË MATËSVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 51 pika 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 25 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.7.2011, pasi shqyrtoi draftin e propozuar nga DPM-ja dhe përpunuar nga grupi i punës, për kontratën tip për shërbimin e verifikimit, kontrollit fillestar dhe periodik të matësve të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Të miratojë kontratën tip për shërbimin e verifikimit, kontrollit fillestar dhe periodik të matësve të energjisë elektrike (bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektin e interesuar për vendimmarrjen e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

KONTRATË SHËRBIMI

Për shërbimin e verifikimit, kontrollit fillestar dhe periodik të matësve të energjisë elektrike Në Tiranë, sot më datë _____/2011, lidhet kjo kontratë shërbimi për kontrollin fillestar e periodik të matësve (kontrata) nga dhe ndërmjet:

1. Shoqërisë “ _____ ” sh.a./sh.p.k., person juridik i së drejtës shqiptare, me seli në _____, regjistruar me vendimin nr. _____, datë ___/___/___ të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NUIS _____, i përfaqësuar nga administratori/person i autorizuar z/zj. _____, këtu e më poshtë i quajtur “Shpërndarësi” ose “ _____ ” i licencuar nga ERE për ushtrimin e aktivitetit të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe,

2. Shoqërisë “ _____ ” sh.p.k., person juridik i së drejtës shqiptare, me seli në _____, regjistruar me vendimin nr. _____, datë ___/___/___ të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NUIS _____, i përfaqësuar nga administratori z. _____, këtu e më poshtë i quajtur “Kontraktori” i licencuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.

Të cilët, gjithashtu, këtu dhe më poshtë mund të quhen bashkërisht si palët ose veç e veç si pala.

Palët me cilësitë që u njeh ligji në Republikën e Shqipërisë dhe vullnet të lirë, bien dakord të nënshkruajnë dhe respektojnë këtë kontratë si më poshtë vijon:

I. BAZA LIGJORE

Palët nënshkruajnë këtë kontratë, bazuar në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, Kodin e Matjes, ligjin nr.9875, datë 14.2.2008 “Për metrologjinë”, të ndryshuar, si dhe legjislacionin në fuqi që rregullon përkatësisht marrëdhëniet në Republikën e Shqipërisë.

II. TË PËRGJITHSHME

2.1. Kjo kontratë do të përdoret për të siguruar dhe rregulluar marrëdhëniet ndërmjet palëve për realizimin e shërbimit të kontrollit fillestar e periodik të matësve të energjisë elektrike, këtu e më poshtë të quajtura në tërësi Shërbimet e Kontrollit, të cilësuara në anekset e kësaj kontrate.

2.2 Kontrata përmban pjesën e përgjithshme dhe anekset e listuara në aneksin A-Përmbajtja e në vijim. Përkufizimet e termave dhe konceptet e përdorura në këtë kontratë paraqiten në aneksin A-Përkufizime. Anekset janë pjesë përbërëse integrale të kontratës.

2.3. Në interpretimin e kontratës, anekseve bashkëngjitur ose shtesave që janë pjesë e saj, termat në vijim do të kenë kuptimin e përkufizimeve sipas ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Kodit të Matjes, ligjit nr.9875, datë 14.2.2008 “Për metrologjinë”, të ndryshuar, akteve, të dala në zbatim të tyre dhe përkufizimeve sipas aneksit 2 të kësaj kontrate.

III. OBJEKTI I KONTRATËS

3.1 Objekt i kësaj kontrate midis palëve konsiston në realizimin e shërbimeve në përputhje me nenin 51 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar si më poshtë:

- Verifikimin e saktësisë së tipit të miratuar të aparateve matëse të energjisë elektrike, kur vendosen në treg për herë të parë dhe/ose në përdorim (instalim);
- Inspektimin periodik për verifikimin e saktësisë së aparateve matëse dhe të sistemit të matjes së energjisë elektrike, kolaudimin, të vulosjes, si dhe të mirëmbajtjes së tyre.

3.2 Kontrolli, verifikimi dhe kolaudimi i instrumenteve matëse do të kryhet konform metodikave dhe standardeve të mëposhtme të miratuara nga DPM-ja.

- i) Metodika “Kërkesa metrologjike për njehsorët induktivë të energjisë elektrike (format i adaptuar i instruksionit për kontrollin, kolaudimin dhe remontin e kontatorëve elektrikë)”;
- ii) Standardi SSH EN 62053-11:2003 “Pajisje matëse elektrike e rrymës alternative – kërkesa të veçanta”, pjesa 11: “Matësit elektromekanik për energjinë aktive (klasa 0.5;1 dhe 2)”;
- iii) Standardi SSH EN 62053-21:2003 “Pajisje matëse të rrymës alternative – Kërkesa të veçanta pjesa 21: “Matësit elektronikë të energjisë aktive (klasa 1 dhe 2)”;
- iv) Direktiva europiane e instrumenteve matëse – MID, aneksi III;
- v) Instruksion për kontrollin, kolaudimin dhe remontin e kontatorëve elektrikë;
- vi) Udhëzimin metodik nr.29-88 të DPM-së.

IV. TË DREJTAT E DETYRIMET E PALËVE

4.1 Palët do të bashkërendojnë programin e punës për realizimin praktik të objektit të kontratës, duke ngritur strukturat përkatëse për koordinim, bashkërendim e për organizimin e punës. Palët mbajnë përgjegjësi reciproke për zbatimin në kohë të këtij programi.

4.2 Shpërndarësi garanton kushtet normale organizative e teknike për punë të grupeve të punës për dorëzimin e dokumentacionit të plotë të verifikimit, kolaudimit e vulosjes së matësve elektrikë, si dhe do të japë informacion të plotë për gjendjen e tyre teknike në zbatim të këtij programi.

4.3 Shpërndarësi brenda 10 ditëve pune nga nënshkrimi i kontratës merr masa për koordinimin e veprimtarisë me kontraktorin për realizimin e shërbimeve të kontrollit, shpërndarësi ka detyrimin që, në përputhje me programin e organizimit të kontrollit, të kryejë paraparakisht lajmërimin e konsumatorëve, 24 orë para, matësit e të cilëve do të kontrollohen.

4.4 Shpërndarësi ka detyrimin t'i sigurojë akses të plotë e të sigurt në të gjitha zonat dhe ambientet ku duhet të kryhen shërbimet e kontrollit.

4.5 Kontraktori duhet t'i kryejë dhe përmbushë shërbimet dhe detyrimet e tij në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore dhe rregullatore dhe me karakteristikat teknike specifike të matësve të energjisë.

4.6 Marrja në dorëzim e dokumentacionit dhe kryerja e shërbimeve nga kontraktori do të evidentohet nëpërmjet procesverbaleve të hartuara me shpërndarësin. Kontraktori ka detyrimin të informojë DPM-në për kontrollin periodik për verifikimin e saktësisë së matësve dhe të sistemit të matjes së energjisë elektrike nëpërmjet relacioneve.

4.7 Secila palë merr përsipër që të mos bëjë ndryshime në sistemin e matjes, ose çdo pajisje që përfshihet në të, ose çdo komandë ose protokoll që ruhet, ndryshim, i cili mund të ndikojë ose dëmtojë funksionimin e pajisjeve të palës tjetër.

4.8 Në rast se ndonjëra nga palët dëshiron të bëjë ndryshime apo të kërkojë shërbime të veçanta veç atyre të parashikuara në këtë kontratë, ajo duhet të njoftojë palën tjetër. Mënyra e njoftimit do të kryhet sikurse është përcaktuar në këtë kontratë.

4.9 Informacioni i ruajtur nga secila palë do t'i jepet palës tjetër, së cilës i është dhënë e drejta ta përdorë këtë informacion në atë masë të përcaktuar në këtë kontratë. Kontraktori do të krijojë arkivën fizike dhe elektronike sipas standardeve të legjislationit në fuqi.

4.10 Palët kanë detyrimin që:

- të njoftojnë njëra-tjetrën për çdo situatë parregullsie të konstatuar nga autoritetet shtetërore të kontrollit, si dhe për çdo pezullim apo heqje të lejeve/licencave, autorizimeve etj., që kanë të bëjnë me shërbimet e kontrollit;
- të njoftojë menjëherë shpërndarësin për procedim ligjor që ka për objekt shërbimet e kontrollit, përjashtuar ato të përcaktuara me ligj;
- të mbajë të informuar shpërndarësin për zhvillimet në situatat dhe procedimet e lartpërmendura.

4.11 Në lidhje me sa përshkruar në paragrafin 4.16, kontraktori mund të marrë masa për pezullimin dhe/ose ndërprerjen e shërbimeve të kontrollit, në varësi të shkallës së rëndësisë dhe impaktit të ngjarjes në fjalë.

4.12 Shpërndarësi ka detyrim që:

- sipas grafikut të miratuar nga DPM-ja të sjellë në laboratorin e kontraktorit kontatorët e energjisë dhe të bëjë dorëzimin e dokumentacionit të tyre për verifikim, kolaudim e vulosjen e tyre;
- të verifikojë ekzistencën e certifikimit, testimit dhe vulosjes së moseterisë e makinerisë të matësit e sistemit të matjes nga laboratorit i autorizuar para kryerjes së lidhjeve të reja;
- të mos modifikojë e dëmtojë vulat e vendosura nga kontraktori.

4.13 Kontraktori kryen verifikimin, kolaudimin dhe vulosjen e makinerisë të matësve të energjisë elektrike që rezultojnë në rregull. Për matësit e energjisë elektrike që rezultojnë nga verifikim-kolaudimi të parregullt nuk bëhet vulosje e makinerisë së tyre.

4.14 Kontraktori përgatit dhe ruan të dhënat e rezultateve të verifikimit në arshivë dhe përgatit dokumentin e dorëzimit sipas formatit të bashkërenditur ndërmjet palëve.

V. DHËNIA E INFORMACIONIT

Shpërndarësi ka detyrimin t'i sigurojë e t'i vendosë në dispozicion kontraktorit asistencën dhe të gjithë dokumentacionin dhe regjistrimet që kanë të bëjnë me matësit e energjisë së klasës së saktësisë 0.5, 1 dhe 2 njëfazore dhe trefazore të përdorur prej tij.

VI. KONTROLLI DHE SIGURIA NË PUNË

6.1 Në përputhje me legjislacionin për sigurinë në punë dhe parandalimin e aksidenteve, shpërndarësi ka detyrimin të sigurojë kontraktorin me informacionin e plotë e të detajuar në lidhje me risqet specifike ekzistuese në vendet ku do të ushtrohet kontrolli nga punonjësit e kompanive që realizojnë shërbimin e kontrollit.

6.2 Palët, gjithashtu, kanë detyrimin të bashkëpunojnë dhe koordinojnë për sa i përket zbatimit të rregullave të sigurimit teknik për shmangien e rrezikut në punë dhe parandalimin e aksidenteve që ndikojnë në punën e kompanive.

VII. MODIFIKIMI I KUSHTEVE TË SHËRBIMEVE

7.1 Kontraktori mund të ndryshojë ose të modifikojë procedurat e shërbimeve të tij, duke ndjekur referencat e standardeve apo modifikimet e kërkuara nga legjislacioni ose organet akredituese. Në këto raste, kontraktori do të njoftojë paraprakisht shpërndarësin për këto ndryshime.

7.2 Të gjitha kostot e shërbimit të shkaktuara nga rishikimi i procedurave do të jenë në përputhje me tarifat e përcaktuara në bazë të nenit 51, pika 12 e ligjit nr.9072, datë 22.5.2003.

VIII. TARI FAT – PAGESA PËR SHËRBIMET

TARI FAT – TË PËRGJITHSHME

8.1 Tarifat e shërbimit sipas kësaj kontrate do të jenë ato të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë të Financave dhe të ministrit përgjegjës për ekonominë.

8.2 Brenda 5 (pesë) ditëve nga nënshkrimi i kësaj kontrate, shpërndarësi do të ngurtësojë në një nga institucionet financiare të Republikës së Shqipërisë, një sasi lekësh të barabartë me 75% të vlerës së shërbimit të parë që do të kryhet nga kontraktori.

8.3 Shpërndarësi do t'i kryejë kontraktorit pagesën paraprake të barabartë me 25% të vlerës të çdo shërbimi, brenda 5 ditëve pune, nga dita kur shpërndarësi ka rënë dakord me shkrim për kryerjen e shërbimit të kërkuar.

IX. FATURIMI – PAGESA

9.1 Pagesa e shërbimeve do të kryhet kundrejt faturimit (sipas situacioneve) të tyre nga ana e kontraktorit dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e lëshimit të faturës. Për pagesa tej këtij afati do të aplikohet një kamatëvonesë e barabartë me normën e interesit të Yeldit mesatar të bonove të thesarit me maturim njëvjeçar të publikuar nga Banka e Shqipërisë.

9.2 Termat e faturimit dhe të pagesës përcaktohen në mënyrë më specifike në aneksin-FATURIMI.

9.3 Në rast të moskryerjes qoftë edhe pjesërisht të detyrimeve, kontraktori ka të drejtën e pezullimit të ofrimit të shërbimeve deri në kryerjen e saj të plotë nga shpërndarësi, pa pasur asnjë lloj përgjegjësie ndaj shpërndarësit dhe/ose të tretëve.

X. KËRKESA TEKNIKE DHE TË TJERA KËRKESA TEKNIKE

10.1 Palët janë përgjegjëse që kushtet e pajisjeve dhe shërbimet përkatëse të tyre të jenë në përputhje me specifikimet teknike për të cilat kanë rënë dakord, si dhe me specifikimet teknike, që janë, gjithashtu, të zbatueshme si rrjedhojë e kushteve ligjore dhe akteve ligjore të nxjerra nga DPM-ja dhe ERE për këtë qëllim.

10.2 Proceset e punës të verifikimit të kontatorëve të energjisë elektrike në laborator do të jenë në përputhje me procedurat e miratuara nga DPM-ja.

10.3 Për kryerjen e inspektimit e kontrollit periodik të kontatorëve (matësve elektrikë)

Kontraktori do të përdorë matës etalon portabël. Matësit etalon portabël të kontrollit do të përdoren për kontrollin ose testimin periodik të pajisjeve të matjes së energjisë elektrike, të cilat duhet të testojnë në përputhje me fuqi, si dhe me standardet të IEC-së për matësit e energjisë elektrike, Kodin e Matjes. Për këtë qëllim do të kryhen testet minimale, si:

- a) Formën e karakteristikës së ngarkesës;
- b) Përcaktimin e ndjeshmërisë;
- c) Mungesën e vetëlëvizjes.

10.4 Terminologjia e përdorur në manualin e cilësisë dhe dokumentet e tjera lidhur me të janë konform Fjalorit Ndërkombëtar të Metrologjisë, konceptet themelore dhe të përgjithshme shoqëruar me termat.

XI. PLANIFIKIMI

Palët do të hartojnë planin e realizimit të objektit të kontratës në përputhje me programin e miratuar nga DPM-ja.

XII. MBROJTJA E RRJETEVE DHE SIGURIA

Sistemi i menaxhimit të procesit të regjistrimit dhe kolaudimit të matësve elektrikë do të bëhet sipas udhëzimeve të miratuara nga DPM-ja.

Dokumentacioni i sistemit të regjistrimit dhe menaxhimit të të dhënave që kontraktori do të realizojë do të bëhet konform kërkesave të DPM-së.

XIII. TË DREJTAT E PRONËSISË INTELEKTUALE

13.1 Palët gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale për efekte të rregullimit të marrëdhënieve që lindin dhe zhvillohen për shkak të saj.

13.2 Kur pronësia intelektuale zhvillohet në lidhje me zbatimin e kontratës, atëherë në mungesë të ndonjë marrëveshje tjetër midis palëve, pronësia intelektuale do t'i mbetet palës, e cila e zhvilloi atë, gjithmonë me kusht që sipas kësaj marrëveshjeje, pala tjetër duhet të ketë një licencë të shkruar që të përdorë pronësinë intelektuale pa pagesë me qëllim zbatimin e kontratës.

XIV. FORCA MADHORE

14.1 Asnjëra nga palët nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë shkelje të marrëveshjes në qoftë se ajo shkaktohet nga forca madhore, siç përcaktohet nga neni 3, pika 40 e ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike".

14.2 Pala e prekur nga një ngjarje e tillë do të njoftojë menjëherë palën tjetër për shkallën dhe kohëzgjatjen përafërsisht të kësaj pamundësie për të përmbushur detyrimet e saj dhe të paraqesë brenda 20 ditëve nga njoftimi i dhënë dokumente të vërtetuara nga organet kompetente në vend.

14.3 Me pushimin e vonesave ose të humbjeve që kanë rezultuar nga kjo ngjarje, pala e prekur do të njoftojë palën tjetër për këtë ndërprerje.

XV. KONFIDENCIALITETI

15.1 Informacionet, korrespondencat dhe çdo dokument tjetër i shkëmbyer mes palëve për shkak të kontratës dhe marrëdhënieve që lindin ose rregullohen prej saj, do të cilësohen konfidencial dhe do t'u nënshtrohen prej palëve trajtimit ligjor si material konfidencial dhe nuk do të përdoret përtej qëllimit të tyre.

15.2 Aksesi dhe konsultimi i dokumenteve që lidhen me shërbimet e kontrollit është i rezervuar për funksionet e përfshira në dhe nuk mund t'u bëhen të njohura të tretëve përveç se atyre funksioneve të përfshira në procesin e shërbimeve të kontrollit dhe palëve.

15.3 Përjashtohen nga rregulli i mësipërm informacioni ose çdo dokument tjetër:

- që është siguruar në mënyrë të ligjshme nga të tretët;

- që njihej si i ligjshëm për t'u publikuar nga marrësi në ditën e marrjes;
- që është i lirë në zotërim të publikut.

15.4 Nëse informacione që kanë të bëjnë me shpërndarësin duhet t'u bëhen të ditura të tretëve për shkak të detyrimeve ligjore, kontraktori do të informojë shpërndarësin në një afat të përshtatshëm.

XVI. AFATI, HYRJA NË FUQI DHE VLEFSHMËRIA

16.1 Kontrata hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët dhe është e vlefshme për një periudhë jo më pak se dy vjet dhe jo më shumë se tre vjet me të drejtë përsëritjeje.

16.2 Pas mbarimit të këtij afati palët kanë të drejtë të nënshkruajnë një kontratë të re në zbatim të ligjit. Tre muaj përpara mbarimit të kësaj kontrate, palët fillojnë negociatat për rinovimin e saj.

16.3 Asnjë amendament ose ndryshim, apo heqje dore nga të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj kontrate nuk do të jetë i vlefshëm pa qenë me shkrim, dhe pa u miratuar nga ERE.

XVII. PËRFUNDIMI, NDËRPRERJA E KONTRATËS

17.1 Kontrata përfundon nëse:

- plotësohet afati i vlefshmërisë i parashikuar në nenin XVI;
- ndonjëra nga palët njofton 60 ditë përpara ndërprerjen e marrëveshjes në mënyrë të njëanshme për arsye të parashikuara në këtë marrëveshje;
- ndonjëra nga palët ose bashkërisht mbyllin aktivitetin para afatit me vendim gjykate për arsye të parashikuar në legjislacionin shqiptar;
 - për shkak të ndryshimeve në legjislacion.

17.2 Palët mund të ndërpresin në mënyrë të njëanshme dhe të menjëhershme kontratën vetëm kur njëra nga palët:

- Nuk kryen pagesën brenda afateve të parashikuara në këtë kontratë;
- Shkon drejt likuidimit ose është deklaruar në falimentim;
- Nuk respekton dhe/ose nuk zbaton në mënyrë të përsëritur kushtet e kontratës;
- Si pasojë e një vendimi të formës së prerë të gjykatës.

17.3 Përfundimi i kësaj kontrate nuk shuan detyrimet e mbartura midis palëve gjatë vlefshmërisë së kontratës.

XVIII. KALIMI TE TË TRETËT

Kontrata nuk mund të kalohet, transferohet apo tjetërsohet nga palët përveçse kur ky veprim është i ligjshëm dhe në konformitet me të drejtat civile që shoqërojnë ndryshime që mund të ndodhin në pronësinë e ndonjërës palë apo të dyjave së bashku.

XIX. PERSONAT E AUTORIZUAR. NJOFTIMET

19.1 Çdo palë mund të emërojë ose autorizojë me shkrim një person/persona ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e njoftimeve dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës ku duhet të përcaktojë edhe shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

19.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër brenda 5 ditëve kalendrike për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit/ve të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

19.3 Çdo njoftim ose komunikim tjetër që kërkohet ose lind si nevojë e zbatimit të kësaj kontrate, do të jetë me shkrim dhe mund të dërgohet dorazi, por me shënimet përkatëse nga sekretaritet ose protokollat e palëve, ose me postë të regjistruar me konfirmim marrje në dorëzim te selia e palës marrëse ose në adresa të tjera të njoftuara më parë me shkrim nga palët, dhe ky njoftim ose komunikim do të konsiderohet si i dërguar rregullisht kur është marrë në dorëzim nga pala tjetër.

XX. LIGJI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

20.1 Kjo kontratë dhe të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të do të rregullohen, interpretohen në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

20.2 Çdo mosmarrëveshje mes palëve, pretendim ose kundërshtim në lidhje me këtë kontratë, ose çdo shkelje, pretendim ose pavlefshmëria e saj do të zgjidhen me negociata.

20.3 Në rast se mosmarrëveshja ndërmjet palëve, që lidhet me zbatimin e procedurave

standarde të verifikimit të matësve, nuk zgjidhet me negocime direkte, atëherë palët i drejtohen DPM-së të vendosë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

20.4 Për të gjitha mosmarrëveshjet e tjera që nuk lidhen me zbatimin e procedurave standarde të verifikimit të matësve, nëse palët nuk arrijnë zgjidhjen me mirëkuptim pas negociatave brenda 30 ditëve, atëherë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

XXI. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

21.1 Çdo ndryshim, modifikimi, heqje apo shtim dispozitash të kësaj kontrate dhe anekseve të saj, nuk do të jetë i vlefshëm nëse më parë nuk është rënë dakord me shkrim për këtë nga palët dhe të jetë miratuar nga ERE.

21.2 Kontrata dhe anekset e saj hartohen në gjuhën shqipe, në 2 kopje, nga një për secilën palë.

PALËT NËNSHKRUESE:

Për kontraktorin

Për shpërndarësin

ANEKSI 1 LISTA E ANEKSEVE

I. Baza ligjore	1
ii. Të përgjithshme	2
iii. Objekti i kontratës	2
iv. Të drejtat e detyrimet e palëve	3
v. Dhënia e informacionit	4
vi. Kontrolli dhe siguria në punë	5
vii. Modifikimi i kushteve të shërbimeve	5
viii. Tarifat – pagesa për shërbimet	5
ix. Faturimi – pagesa	5
x. Kërkesa teknike dhe të tjera	6
xi. Planifikimi	6
xii. Mbrojtja e rrjeteve dhe siguria	6
xiii. Të drejtat e pronësisë intelektuale	7
xiv. Forca madhore	7
xv. Konfidencialiteti	7
xvi. Afati, hyrja në fuqi dhe vlefshmëria	8
xvii. Përfundimi, ndërprerja e kontratës	8
xviii. Kalimi tek të tretët	9
xix. Personat e autorizuar. Njoftimet	9
xx. Ligji i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve	9
xxi. Dispozita përfundimtare	10
aneksi 2: Përkufizime	11
aneksi 3: Tarifat	16
aneksi 4: Faturimi-pagesat	16
aneksi 5: Karakteristikat e matësve	17
aneksi 6: Planizimi i shërbimeve të kontrollit	21
aneksi 7: Shërbimet e kontrollit	25
aneksi 8: Formularët tip	27

ANEKSI 2 PËRKUFIZIME

“Sistemi i matjes” kupton tërësinë e pajisjeve të matjes, si: matësin, automatin, transformatorët e matjes, mbrojtjen e matësit dhe izolatorët, qarqet dhe pajisjet e ruajtjes së të dhënave.

“Matësi i kontrollit” quhet matësi i autorizuar dhe i certifikuar për kontrollin e matjes së energjisë elektrike.

“Instrument matës” është çfarëdo pajisje apo sistem me funksione matëse.

“Metrologji” është shkenca e matjeve.

“Matje” është seria e veprimeve për përcaktimin e vlerës së një madhësie fizike apo kimike

“Njësi matjeje” është madhësia e caktuar, e pranuar me marrëveshje, për të shprehur në mënyrë sasiore madhësi të tjera të së njëjtës natyrë.

“Tipi i instrumentit matës” është një seri instrumentesh matëse, me funksion identik, bazuar në të njëjtin parim, që kanë të njëjtin projekt dhe që janë prodhuar nga i njëjti prodhues, në bazë të të njëjtit dokumentacion teknik dhe teknologjik.

“Etalon matjeje” është masë matjeje, instrument matës, material referues ose sistem matës i paracaktuar që të përcaktojë, të realizojë, të ruajë ose të riprodhojë një njësi ose më shumë vlera të një madhësie, për t’i transmetuar ato, me anë të krahasimeve, me instrumente të tjera matëse.

“Etalon referues” është një etalon që, përgjithësisht, ka cilësinë më të lartë metrologjike në një vend apo organizatë të dhënë, nga i cili rrjedhin matjet e bëra.

Ruajtje e etalonit të matjes janë të gjitha veprimet e nevojshme për të ruajtur karakteristikat metrologjike të etalonit të matjes, brenda kufijve të caktuar

“Verifikim periodik i një instrumenti matës” është një verifikim i kryer periodikisht dhe në përputhje me rregullat.

“Verifikim jashtë radhe i instrumentit matës” është një verifikim i kryer pas rimodelimit, eliminimit të mosfunksionimeve ose defekteve të tjera teknike (riparim) apo i kryer jashtë periudhës së verifikimit.

“Autorizim” është dhënia e së drejtës për të kryer shërbime të metrologjisë ligjore të instrumenteve matëse në sferën e detyrueshme, subjekteve publike dhe private, vendase ose të huaja, që kryejnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

“Certifikim” është veprimtaria, nëpërmjet së cilës një palë e tretë dhe e pavarur dëshmon zyrtarisht se një produkt, proces apo shërbim është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në udhëzimet metodike të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, ose në përputhje me standardet e përcaktuara.

“Matje zyrtare” është një matje e kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose nga personi juridik i autorizuar (më poshtë ekzekutues i matjes zyrtare), në përputhje me vendimin administrativ për autorizim. Matja zyrtare përdoret si evidencë e besueshme në procedurat dhe vendimmarrjet e organizmave qeveritarë apo të gjykatave.

“Verifikim fillestar i instrumenteve matëse” është kontrolli i një instrumenti të ri apo të riparuar dhe vërtetimi i përputhjes së instrumentit matës me tipin e miratuar për klasën e saktësisë.

“Lejim për hedhje në treg ose vënie në shërbim të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara” është leja e dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për hedhjen në treg ose vënien në shërbim të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, të cilat nuk kanë shenjën e verifikimit fillestar.

“Kodi i matjes” përcakton kërkesat teknike të ndërtimit dhe shfrytëzimit të sistemit të matjes së energjisë elektrike, që do të jetë i përshtatshëm për matje, për mbledhjen e të dhënave, regjistrimin e tyre dhe zbatimin e procedurave përkatëse sipas rregullave të tregut dhe marrëveshjeve midis palëve. Kodi i Matjes përmban normat minimale të detyrueshme për matjen dhe regjistrimin e energjisë elektrike, me qëllim tregtimin e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë.

“Ditët e punës” kupton çdo ditë përveç të shtunës dhe të dielës dhe ditë feste zyrtare në territorin e Republikës së Shqipërisë.

“Matës (kontator) i energjisë elektrike aktive” është një pajisje, e cila mat energjinë elektrike aktive të konsumuar në një qark.

I = rryma elektrike që kalon nëpërmjet matësit;

I_n = rryma referuese e specifikuar, për të cilin është projektuar matësi që funksionon me transformator;

I_{st} = vlera më e ulët e deklaruar e I-së, për të cilën matësi regjistron energjinë elektrike aktive, për koeficientin e fuqisë një (matës shumëfazorë, me ngarkesë simetrike);

I_{min} = vlera e I-së, për të cilën gabimi është brenda gabimeve maksimale të lejueshëm (GML-të) (matës shumëfazorë, me ngarkesë simetrike);

I_{tr} = vlera e I-së, për të cilën gabimi është brenda GML-së më të vogël që i korrespondon tregësit të klasës së matësit;

I_{max} = vlera maksimale e I-së për të cilin gabimi shtrihet brenda GML-ve;

U = tensioni i ushqimit në matës;

U_n = tensioni referues, i specifikuar;

f = frekuenca e tensionit ushqyes në matës;

f_n = frekuenca referuese, e specifikuar;

PF = faktori i fuqisë $\cos\phi = \cos$ inusin e ndryshimit në fazë (diferencës fazore) ϕ ndërmjet I dhe U.

“Certifikim” kuptohet veprimtaria nëpërmjet së cilës një palë e tretë dhe e pavarur dëshmon zyrtarisht se një produkt, proces ose shërbim është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në udhëzimet metodike të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit ose në Standarde.

“Periudha e marrëveshjes” kupton kohën gjatë së cilës përmbushen vlerat kontraktuale të energjisë elektrike sipas marrëveshjes tregtare midis personave apo palëve. Kjo periudhë është një vlerë e plotë e kohës së kërkesës për energji elektrike.

“Shpërndarësi” është “Operator i Sistemit të Shpërndarjes” përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes.

“Enti Rregullator i Energjisë (ERE)” është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror.

“Kalibrim”, tërësia e veprimeve që përcakton, në kushte të veçanta, marrëdhënien ndërmjet vlerave të treguara nga një instrument ose sistem matës, ose të vlerave të dhëna nga një masë materiale, si dhe të vlerave të njohura, korresponduese të instrumentit të matur.

“Verifikim” është konfirmimi nëpërmjet ekzaminimit dhe evidentimit, nëse janë plotësuar kërkesat specifike, tekniko-metrologjike.

“Verifikim i rregullt i një instrumenti matës”, verifikim i kryer periodikisht për klasën e saktësisë.

“Inspektim” shqyrtimi i një produkti, shërbimi, procesi ose sistemi matës, me anë të përcaktimit të përputhjes së tyre me kërkesat specifike ose në bazë të një gjykimi profesional, me kërkesa të përgjithshme.

“Miratim i tipit të instrumenteve matëse”, pranimi i këtyre instrumenteve për verifikim fillestar dhe, kur kjo e fundit nuk kërkohet, autorizimi për t’i hedhur ato në treg dhe/ose për t’i vënë në shërbim.

“Kolaudim”, testim, provë, kontroll, analizë. Testim i pajisjes/punës në kushte mjedisore, ka për qëllim të fusë instrumentet matëse brenda klasës së saktësisë.

“SRM”, sistemi i regjistrimit të matjeve.

“Shërbim i parë” do të quhet ai shërbim që kryhet për herë të parë sipas programit të përcaktuar DPM-së.

ANEKSI 3 TARIFAT

1. Tarifat që do të aplikohen për shërbimet objekt i kësaj kontrate, bazohen në nenin 51 pika 12 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit përgjegjës për Ekonominë.

2. Shpërndarësi detyrohet të bëjë tërheqjen e matësve të kolauduar, verifikuar dhe vulosur në laborator brenda 5 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit nga ana e kontraktorit, në të kundërt ai gëzon të drejtën e aplikimit të tarifave shtesë për magazinimin dhe ruajtjen e tyre sipas legjislacionit në fuqi.

ANEKSI 4 FATURIMI, PAGESAT

1. Faturimi

1.1 Faturimi do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

1.2 Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në lidhje me shërbimet e realizuara, secila nga palët ka të drejtë të fillojë procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, siç detajohet në pikat e mëposhtme.

2. Kryerja dhe mënyra e pagesave

2.1 Të gjitha pagesat që palët duhet të bëjnë sipas kësaj kontrate, do të bëhen në adresat financiare të mëposhtme:

2.3 Për faturim do të zbatohet fatura tatimore, duke aplikuar edhe TVSH-në në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Procedura për kryerjen e pagesës:

Kontraktori i drejtohet shpërndarësit me shkrim, duke paraqitur origjinalin dhe kopjen, së bashku me një listë të shërbimeve të kryera për të cilat duhet paguar.

2. Në rast se shpërndarësi nuk pranon të kryejë pagesën e parashikuar me sipër, atëherë kontraktori i drejtohet DPM-së, e cila brenda 5 ditëve pune duhet të bëjë verifikimin e shërbimit të deklaruar nga kontraktori, në qoftë se DPM-ja, pasi bën verifikimet e nevojshme, bindet se shërbimi është kryer, i drejtohet institucionit financiar ku është bërë sigurimi i kontratës nga shpërndarësi, për të kaluar në llogarinë e kontraktorit vlerën në lekë të shërbimit të realizuar nga kontraktori.

Në qoftë se vlera në bankë për sigurimin e shërbimit është e pamjaftueshme për të kryer pagesën, DPM-ja vepron në përputhje me kompetencat që i jep ligji për këto raste.

3. Ruajtja e të dhënave

Palët janë të detyruara të ruajnë të gjitha të dhënat, mbi bazën e të cilave janë bërë faturimet për një periudhë jo më pak se 2 (dy) vjet nga data e faturimit.

ANEKSI 5 KARAKTERISTIKAT E MATËSVE

KËRKESA TË VEÇANTA

5.1 Saktësia

Fabrikuesi duhet të specifikojë treguesin e klasës së matësit. Treguesit e klasave përcaktohen, si: klasa A(2), B(1) dhe C(0,5).

5.2 Kushtet e vlerësuara të funksionimit

Fabrikuesi duhet të specifikojë kushtet e rendit të funksionimit për matësin, veçanërisht:

Vlerat e f_n , U_n , I_n , I_{st} , I_{min} , I_{tr} dhe I_{max} që zbatohen për kontatorin. Për vlerat referuese të rrymës, matësi duhet të përmbushë kushtet e dhëna në tabelën 1.

Tabela 1

	Klasa A(2)	Klasa B(1)	Klasa C(0,5)
Për kontatorët e lidhur drejtpërdrejt			
I_{st}	$\leq 0,05 \cdot I_{tr}$	$\leq 0,04 \cdot I_{tr}$	$\leq 0,04 \cdot I_{tr}$
I_{min}	$\leq 0,5 \cdot I_{tr}$	$\leq 0,5 \cdot I_{tr}$	$\leq 0,3 \cdot I_{tr}$
I_{max}	$\geq 50 \cdot I_{tr}$	$\geq 50 \cdot I_{tr}$	$\geq 50 \cdot I_{tr}$
Për kontatorët që lidhen me transformatorë			
I_{st}	$\leq 0,06 \cdot I_{tr}$	$\leq 0,04 \cdot I_{tr}$	$\leq 0,02 \cdot I_{tr}$
I_{min}	$\leq 0,4 \cdot I_{tr}$	$\leq 0,2 \cdot I_{tr}$ (1)	$\leq 0,2 \cdot I_{tr}$
I_n	$= 20 \cdot I_{tr}$	$= 20 \cdot I_{tr}$	$= 20 \cdot I_{tr}$
I_{max}	$\geq 1,2 \cdot I_n$	$\geq 1,2 \cdot I_n$	$\geq 1,2 \cdot I_n$

Diapazonet e tensionit, frekuencës dhe faktorit të fuqisë, brenda të cilave matësi duhet të përmbushë kërkesat e GML-së specifikohen në tabelën 2. Këto diapazone duhet të përputhen me karakteristikat tipike të energjisë elektrike të furnizuar nëpërmjet sistemeve publike të shpërndarjes.

Diapazonet e tensionit dhe të frekuencës duhet të jenë të paktën:

$$0,9 \cdot U_n \leq U \leq 1,1 \cdot U_n$$

$$0,98 \cdot f_n \leq f \leq 1,02 \cdot f^n$$

Ndërsa diapazoni i koeficientit të fuqisë nga të paktën $\cos \varphi$ induktive = 0,5 deri në $\cos \varphi$ kapacitive = 0,8.

5.3. Gabimet maksimale të lejuara (GML)

Ndikimet e madhësive matëse dhe influencuese (a, b, c, . . .) vlerësohen secila më vete. Të gjitha madhësitë e tjera të matjeve dhe influencuese që ndikojnë në matje mbahen relativisht konstante në vlerat e tyre të referencës. Gabimi i matjes, i cili nuk duhet të kapërcejë GML-në e deklaruar në tabelën 2, llogaritet si:

$$\text{Gabimi i matjes} = (a^2 + b^2 + c^2 \dots)^{1/2}$$

Kur matësi punon në rryma me ngarkesa të ndryshueshme, gabimet në përqindje nuk duhet të kapërcejnë kufijtë e dhënë në tabelën 2.

Tabela 2

GML-TË NË PËRQINDJE NË KUSHTET E VLERËSUARA TË FUNKSIONIMIT DHE NIVELET E PËRCAKTUARA TË RRYMËS SË NGARKESËS DHE TEMPERATURA E FUNKSIONIMIT

Temperaturat e punës	Temperaturat e punës			Temperaturat e punës			Temperaturat e punës					
	+ 5°C... +30°C			-10 °C.... + 5°C ose +30 °C . . +40 °C			- 25°C... - 10 °C ose + 40 °C . . + 55 °C			- 40 °C.... - 25 °C ose + 55 °C . . + 70 °C		
klasa	A	B	C	A	B	C	A	B	C	A	B	C
Matësi njëfazor: matësi shumëfazor me ngarkesë simetrike												
$I_{min} \leq I < I_{tr}$	3.5	2	1	5	2.5	1.3	7	3.5	1.7	9	4	2
$I_{tr} \leq I \leq I_{max}$	3.5	2	0.7	4.5	2.5	1	7	3.5	1.3	9	4	1.5
matësi shumëfazor me ngarkesë në një fazë të vetme												
$I_{tr} \leq I \leq I_{max}$ shih përjashtimin më poshtë	4	2.5	1	5	3	1.3	7	4	1.7	9	4.5	2
Për matësit elektromekanikë shumëfazorë, diapazoni i rrymës për ngarkesën njëfazore kufizohet në $5I_{tr} \leq I \leq I_{max}$												

Kur një kontator punon në regjime temperature të ndryshme, duhet të zbatohen vlerat e mësipërme të GML-ve.

Matësi nuk duhet të lejojë në GML-të shfaqje sistematike në favor të asnjë ane.

5.4. Ndikimi i lejuar nga çrregullimet

5.4.1. Të përgjithshme

Meqenëse matësit elektrikë të fuqisë janë të lidhur drejtpërdrejt me furnizimin kryesor dhe se rryma është, gjithashtu, një prej madhësive të matura, për matësit elektrikë përdoret një mjedis elektromagnetik i veçantë.

Matësi duhet të jetë në përputhje me kërkesat e mjedisit elektromagnetik E2 dhe kërkesat shtesë në 39.4.2 dhe 39.4.3.

Mjedisi elektromagnetik dhe ndikimet e lejuara pasqyrojnë gjendjen kur ka çrregullime me kohëzgjatje të madhe, të cilat nuk duhet të ndikojnë në saktësinë përtej vlerave kritike të ndryshimit dhe të çrregullimeve kalimtare, të cilat mund të shkaktojnë një rënie të përkohshme ose humbje të funksionit ose të performancës, por nga e cila gjendje matësi duhet të rikthehet dhe nuk duhet të ndikohet në saktësinë përtej vlerave kritike të ndryshimit.

Karakteristikat metrologjike të matësit duhet të mbrohen kur ekziston një rrezik i lartë i parashikueshëm për shkak të vetëtimitave ose atje ku rrjetet ajrore të furnizimit janë mbizotëruese.

5. 4.2. Ndikimi i çrregullimeve me zgjatshmëri të madhe

Tabela 3

VLERAT E NDRYSHIMIT KRITIK PËR ÇRREGULLIMET ME KOHËZGJATJE TË MADHE

Çrregullimi	Vlerat e ndryshimit kritik në përqindje sipas klasës së matësit		
	A	B	C
Renditja e kundërt e fazave	1,5	1,5	0,3
Tension josimetrik (i zbatueshëm vetëm për matësit me shumë faza)	4	2	1
Përmbajtja e harmonikave në qarqet e rrymës (1)	1	0,8	0,5
DC dhe harmonikat në qarkun e rrymës (1)	6	3	1,5
Procese të shpejta kalimtare	6	4	2
Fushat magnetike: Fusha elektromagnetike HF (rrezatimi RF): Çrregullime të shkaktuara nga fusha e radiofrekuencës; dhe valët lëkundëse të imunizuara	3	2	1

5.4.3. Ndikimi i lejueshëm i fenomenit elektromagnetik kalimtar

5.4.3.1. Ndikimi i një çrregullimi elektromagnetik në një matës të fuqisë elektrike duhet të jetë i tillë që gjatë dhe menjëherë pas çrregullimit:

a) çdo informacion i parashikuar me synim për të testuar saktësinë e matësit nuk prodhon impulse ose sinjale që i korrespondojnë një fuqie më të lartë sesa vlera kritike e ndryshimit dhe në një kohë të arsyeshme pas çrregullimi matësi duhet;

b) të rifillojë të funksionojë brenda kufijve të GML-së; dhe

c) të ketë të mbrojtura të gjitha funksionet e matjes; dhe

d) të lejojë rikthimin e të gjitha të dhënave të matjes përpara çrregullimit; dhe

e) nuk duhet të shënojë një ndryshim në fuqinë e regjistruar prej më shumë sesa vlera e ndryshimit kritik.

Vlera e ndryshimit kritik në kWh është $m \cdot U_n \cdot I_{max} \cdot 10^{-6}$

(m është numri i elementeve matëse të matësit, U_n në volt dhe I_{max} në amper).

5.4.3.2 Për mbingarkesë vlera kritike e ndryshimit është 1,5 %.

5.5 Përshtatshmëria

5.5.1 Nën voltazhin e regjimit të punës gabimi pozitiv i matësit nuk duhet të kapërcejë 10 %.

5.5.2 Displei energjisë totale duhet të ketë një numër të mjaftueshëm shifrash për të siguruar se kur kontaktori funksionon për 4 000 orë me ngarkesë të plotë ($I = I_{max}$, $U = U_n$ dhe $PF = 1$), treguesi nuk rikthehet në vlerën fillestare të tij dhe nuk do të jetë në gjendje të zerohet gjatë përdorimit.

5.5.3 Në rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike në rrjet, sasi të e matura të energjisë elektrike duhet të mbeten të vlefshme për t'u lexuar gjatë një periudhe të paktën për 4 muaj.

5.5.4 Funkzionimi pa ngarkesë

Kur qarku i tensionit është i kyçur, ndërsa ai i rrymës është i hapur, matësi nuk duhet të regjistrojë energji për asnjë vlerë të tensionit midis $0,8 \cdot U_n$ dhe $1,1 U_n$.

5.5.5 Fillimi

Matësi duhet të fillojë të punojë dhe duhet të vazhdojë të regjistrojë për tensionin U_n , $PF = 1$ (për matësit shumëfazorë me ngarkesë simetrike) dhe për një rrymë, e cila është e barabartë me I_{st} .

5.6 Njësitë

Energjia elektrike e matur duhet të shfaqet në kilovat-orë ose në megavat-orë.

5.7 Palët do të mbajnë të dhënat për sistemet e matjes dhe matësit për çdo pikë matje sipas specifikimeve të Kodit të Matjes.

5.8 SRM-ja do të ketë të regjistruar deri në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate çdo ndryshim të përdoruesve dhe konsumatorëve, të pajisjeve matëse dhe çdo shkëputje të lidhjeve të tyre. 1.5-Të dhënat e SRM-së do të jenë të vlefshme për subjektet apo persona fizikë e juridikë sipas kërkesës të tyre dhe sipas formatit të përcaktuar nga DPM-ja, vetëm me kushtin që këto të dhëna kanë të bëjnë me sistemin e matjes së vetë kërkuarit.

5.9 Matësit në përputhje me IEC ose IEC 61036 (ose standardin europian ekuivalent) do të jene të lidhur me transformatorët e rrymës dhe të tensionit.

ANEKSI 6

PLANËZIMI I SHËRBIMEVE TË KONTROLLIT

1. Të përgjithshme

Për të siguruar funksionimin e rregullt të matësve dhe sigurimin pa ndërprerje të shërbimit periodik ose për çfarëdo defekti tjetër, palët do të bashkëpunojnë për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen sipas kushteve të marrëveshjes në përgjithësi, dhe në mënyrë specifike të këtij aneksi.

Shërbimet jepen në mjediset e kontraktorit, në Tiranë dhe në vende të tjera të kësaj shoqërie, si dhe në mjediset e subjekteve në të cilat janë apo do të instalohen matësit.

Për këtë qëllim dalin përgjegjësitë e palëve si më poshtë:

Njoftimi në rastin e problemeve të rëndësishme, të cilat ndikojnë zbatimin e detyrave që rrjedhin nga ligji e kontrata, palët duhet të njoftojnë njëra-tjetrën në mënyrën e përcaktuar në këtë marrëveshje.

Palët kryejnë veprimtarinë e punimet të planifikuara për të shmangur incidentet e defektet e mundshme që mund të lindin gjatë kryerjes së shërbimit të verifikimit, kolaudimit vulosjes e kontrollit periodik të matësve elektrikë.

2. Personat e kontaktit

Për të realizuar marrëveshjen dhe për mbarëvajtjen e saj, secila palë do të caktojë nga një përfaqësues dhe do t'ia njoftojë atë palës tjetër si person kontakti.

Personat e kontaktit, së bashku do të mbikëqyrin zbatimin në vijueshmëri të kësaj marrëveshjeje. Secili prej tyre do të koordinojë punën me tjetrin dhe do t'i raportojë palës që e ka caktuar, për çdo problem që nuk ka gjetur zgjidhje. Me marrjen e këtij raporti palët duhet të konsultohen me njëra-tjetrën, me qëllim që të arrijnë një zgjidhje të pranueshme për të dyja palët.

Në raste të ankesave për defekt teknik, pikat e kontaktit të palëve janë:

Kontraktori:

Shpërndarësi:

3. Mbrojtja e sistemeve

Secila palë nuk do të kryejë dhe nuk do të lejojë që të kryhen veprime në sistemin e matjes të cilat do t'i shkaktonin dëm palës tjetër.

4. Bashkëpunimi

4.1 Palët do të bashkëpunojnë në kryerjen e veprimeve të pranueshme reciprokisht, për testimin dhe eliminimin e incidenteve e problemeve të shfaqura, të cilat ndikojnë në realizimin dhe funksionimin e qëllimit të kontratës.

4.2 Palët bashkërendojnë aktivitetin e tyre organizativo–teknik për realizimin praktik të objektit të kontratës.

4.3 Në rastet kur gjatë zbatimit në praktikë të kësaj kontrate lind nevoja e domosdoshme për të bërë ndonjë ndryshim apo shtesë të kësaj kontrate, atëherë ajo është e mundshme vetëm pasi të dyja palët të kenë rënë dakord me shkrim dhe këto ndryshime janë miratuar nga ERE.

4.4 Kontraktori, konform kërkesave të standardeve të matjes, është i detyruar të evidentojë saktë të gjitha të dhënat që rezultojnë nga aktiviteti i matjes së kryer në zbatim të objektit të kësaj kontrate. Pas përfundimit të shërbimit të kontrollit në objekt, kontraktori me një akt dorëzimi të veçantë duhet t'i dorëzojë shpërndarësit një kopje të plotë me rezultatet e matjeve të kryera dhe konkluzionet përkatëse. Të dyja palët janë të detyruara të administrojnë, arkivojnë dhe ta ruajnë këtë dokumentacion për një periudhë 10-vjeçare. Kontraktori duhet të krijojë arkivën fizike dhe regjistrimin elektronik sipas standardeve të legjislacionit në fuqi.

4.5 Secila palë merr përsipër që të mos bëjë ndryshime në sistemin e matjes, ose çdo pajisje që përfshihet në të, si dhe të çdo komande ose protokollit që ruhet, ndryshim, i cili mund të ndikojë ose dëmtojë funksionimin e pajisjeve të palës tjetër.

4.6 Secila palë do të sigurojë vazhdimësinë e marrëdhënies ndërmjet tyre, duke u bazuar në parimin e korrektesës në përmbushjen e detyrimeve respektive.

4.7 Shpërndarësi është i detyruar të njoftojë paraprakisht dhe në vazhdim kontraktorin mbi tipin e matësve të rinj që parashikon të blejë, në mënyrë që të sigurohet kontrolli, prova e tyre në kohë e cilësi nga ana e kontraktorit.

4.8 Shpërndarësi është i detyruar të garantojë dhe të sigurojë dhënien e saktë dhe në kohë të të gjithë dokumentacionit të nevojshëm që i shërben kontraktorit për të realizuar në kohë e cilësi objektin e kësaj kontrate.

4.9 Shpërndarësi është i detyruar të garantojë kushtet normale organizative e teknike për punë të grupeve të punës në terren për verifikimin, kolaudimin e vulosjen e pajisjeve matëse elektrike.

4.10 Kontraktori është i detyruar që para fillimit të shërbimit të kontrollit në një objekt, t'i paraqesë për verifikim dhe miratim shpërndarësit programin e detajuar organizativo-teknik të punës për realizimin e këtij procesi dhe fillon zbatimin e tij vetëm pasi ai ka marrë miratimin me shkrim nga shpërndarësi.

5. Të tjera

5.1 Për fillimin e punimeve, zhvillimin dhe mbylljen e shërbimeve të verifikimit, kolaudimit, vulosjes para përdorimit, si dhe gjatë kontrollit e inspektimit periodik, të cilat duhet të bëhen në prezencën mbikëqyrëse të stafit teknik përgjegjës të shpërndarësit, shpërndarësi duhet të realizojë me rigozitet detyrat që rrjedhin nga kërkesat e ligjit, si:

a) Shpërndarësi mirëmban mjediset dhe rrjetin e ushqimit të pajisjeve matëse në përputhje me kërkesat teknike;

b) Zhvillon pajisjet matëse elektrike, në përputhje me perspektivat e zhvillimit dhe të ndryshimit të kërkesës për energji elektrike e shërbime të tjera nga klientët dhe përdoruesit, të nevojshme për të përmbushur detyrimet e tyre, sipas legjislacionit në fuqi dhe njofton kontraktorin DPM e ERE për çdo ndryshim;

c) Të gjitha elementet e lidhura direkt me pajisjet matëse do t'i sigurojë shpërndarësi;

d) Shpërndarësi duhet të japë urdhra për koordinimin dhe manovrimin në sistemin e Shpërndarjes sipas rregullave në fuqi për sigurinë e ruajtjen e personelit të shërbimit të kontraktorit, të cilët do të kryejnë procedurat sipas normave teknike specifike dhe rregullave për testimin e pajisjeve matëse e sigurisë në punë;

e) Shpërndarësi është i detyruar të marrë të gjitha masat e nevojshme për kufizimin e përhapjes së avarive dhe për të ruajtur punën normal në rast të një gjendje të paqëndrueshme veprimi të ekipit testues të kontraktonit;

f) Në rrethanat kur gjatë punës së testimit, rrjeti shpërndarës bie në gjendje avari, kontraktori ndërpret veprimet dhe harton një procesverbal në të cilin pasqyrohen shkaqet e ndërprerjes së punës. Ky procesverbal bashkëfirmoset nga përfaqësuesi i shpërndarësit;

g) Kontraktori e shpërndarësi do të shkëmbejnë raporte me shkrim ose në formë elektronike,

sipas rastit. Raporti do të përmbajë njoftimin me më shumë detaje lidhur me planifikimin e punës, incidentet ose defektet, duke përfshirë edhe informacionet që janë bërë të njohura për incidentin ose defektin pas njoftimit;

h) Aty ku është deklaruar një incident ose defekt dhe është paraqitur një raport, kontraktori ose shpërndarësi mund të kërkojnë me shkrim që të kryhet një hetim i përbashkët. Një grup hetimi do të jetë i nevojshëm për incidentin ose defektin që do të hetohet dhe do të vendoset nga të gjitha palët e përfshira. Një hetim i përbashkët do të zhvillohet nga të gjitha palët e prekura që bien dakord. Format, rregullat, procedurat dhe të gjitha çështjet lidhur me hetimin e përbashkët do të vendosen në marrëveshjen e hetimit të përbashkët. Në mungesë të marrëveshjes, hetimi i përbashkët nuk do të zhvillohet, por do të zhvillohet hetimi nga organet e ngarkuara nga ligji, DPM e ERE.

i) Çështjet në raportin e shkruar për incidentin e rëndësishëm duhet të përfshijnë:

- Datën dhe orën e incidentit të rëndësishëm;
- Vendin;
- Pajisjet e përfshira;
- Përshkrimin e shkurtër të incidentit, dëmet e shkaktuara;
- Detaje të çdo veprimi të ndërmarrë;
- Periudhën e ndërprerjes së punës;
- Konkluzione dhe rekomandime nëse aplikohen;
- Kohëzgjatja e incidentit;
- Data e parashikuar dhe koha e rikthimit në shërbim normal.

5.2. Planifikimi i veprimtarisë për inspektimin, testimin, kolaudimin, regjistrimin e vulosjen e pajisjeve matëse elektrike.

1. Kontraktori dhe operatori shpërndarës planifikojnë punën për zhvillimin me sukses e korrektësi të krijimit të regjistrit të pajisjeve matëse elektrike, inspektimit periodik, testimin, kolaudimit e vulosjes së matësve elektrikë.

2. Planifikimi i zhvillimit të sistemit të matjes ka qëllimet e mëposhtme:

- Të mundësojë planifikimin, projektimin dhe ndërtimin e sistemit të matjes të shpërndarësit me kontraktorin, për të operuar në mënyrë ekonomike dhe të sigurt. Të mundësojë krijimin e aksesit në përdorimin e sistemit të matjes, duke krijuar hapësirat funksionale për ushtrimin me sukses të detyrave nga kontraktori.

- Të formalizojë kërkesat e të dhënave për planifikimin e kontrollit periodik sipas miratimit nga DPM-ja:

- Të njohë me planifikimin e zhvillimit të sistemit të matjeve veprimet operacionale të shpërndarësit, të cilat kushtëzojnë harmonizimin e punës me kontraktorin për realizimin e detyrave të regjistrimit, verifikimit, kolaudimit e vulosjes së matësve periodikë para se të fillojnë punën.

ANEKSI 7

SHËRBIMET E KONTROLLIT

KUSHTET E PËRGJITHSHME DHE RENDI I KONTROLLIT

1. Kontrolli kryhet gjatë procesit të testimit fillestar, kontrollit periodik dhe me kërkesë të konsumatorëve tariforë, si dhe të shpërndarësit. Volumi i kontrollit kryhet në përputhje me procedurat e miratuara nga DPM-ja sipas metodikës nr.29-88 dhe instruksioni për kontrollin, kolaudimin dhe remontin e kontatorëve elektrikë.

2. Të dhënat e SRM-së do të jenë të vlefshme për subjektet apo persona fizikë e juridikë vetëm për sistemin e matjes së tyre, sipas kërkesës së tyre dhe sipas formatit të përcaktuar nga DPM-ja.

Testet e matësve para përdorimit (instalimit)

Të gjitha testet e matësve duhet të bëhen me aparatura testimi të aprovuara nga DPM-ja.

Kontrolli i kontatorëve mund të kryhet me metoda të ndryshme të miratuara nga DPM-ja.

Të gjithë matësit e rinj do të testohen dhe rregullohen për t'u regjistruar me saktësi brenda limiteve të specifikuara në këtë marrëveshje përpara përdorimit (instalimit).

Matësit e konsumatorëve familjarë do të testohen dhe rregullohen para instalimit

(përdorimit) për të regjistruar korrekt brenda klasës së saktësisë $\pm 2\%$, pas procesit të verifikimit konform rregullave të përcaktuara nga DPM-ja.

Transformatorët e rrymës dhe të tensionit do të testohen për të përcaktuar raportin e tyre (koeficientin e transformacionit) dhe saktësinë. Këto teste do të bëhen nga laboratorit i autorizuar nga DPM-ja.

Inspektimi e kontrolli periodik i kontatorëve (matësve elektrikë)

Inspektimi dhe testimi me kërkesë të klientëve

Me kërkesën e klientit, laboratorit i kontraktorit është i detyruar t'i dorëzojë klientit protokollin e testit për matësin e tij. Një kopje e përmbledhjes së këtij raporti mbahet në arshivën e kontraktorit dhe një kopje dërgohet në zyrat e shpërndarësit, i cili kryen likuidimin financiar ndaj kontraktorit.

Testet e matësve me standard metër portabël

1. Inspektimi e kontrolli periodik i matësve elektrikë mund të bëhet edhe me metodën e kontrollit me etalon kampione portative të quajtur "matës standard portabël" dhe instrumentet e tjera portabël të përdorura për matësit testues.

2. Kontrolli në vendin e montimit kryhet në prani të konsumatorit, si dhe përfaqësuesit të shpërndarësit të cilit i përket kontatori, i cili lejon dhe kryen nëpërmjet personelit të shpërndarësit çkyçjet dhe kyçjet e ngarkesës. Përgjegjësinë për respektimin e rregullave të sigurimit teknik, e mbajnë palët, shpërndarësi dhe kontraktori. Kontraktori nuk ka të drejtë të bëjë lidhje në qarqet primare dhe kyçje ose çkyçje të ngarkesës.

Proceset e punës të verifikimit të kontatorëve të energjisë elektrike në laborator përcaktohen nga DPM-ja.

Vulosja e matësve elektrikë

Morseteria e aparatit matës të energjisë elektrike bashkëvulohet, pas instalimit të konsumatorit nga kontraktori dhe shpërndarësi me vula të miratuara nga DPM.

ANEKSI 8
FORMULARËT TIP

AKTKONTROLI

I mbajtur sot më datë pranë laboratorit të kontrollit dhe kolaudimit të matësve elektrikë në prani të:

1		
2		

Matësi u soll pranë laboratorit nga:

z. punonjës pranë

KARAKTERISTIKAT DHE TË DHËNAT E MATËSIT ELEKTRIK	
Njëfazor	
Trefazor	
Aktiv	
Reaktiv	
Tipi i matësit	
Nr. i serisë	
Tensioni	
Rryma	
Nr. rrot.(imp)/KWh,KWArh	
Gjendja e leximit	
Nr. i vulës së makinerisë	
Nr. i raportit (prot.)	

Pasi u vu në stendë dhe u kontrollua rezultoi:

Ka vetëlëvizje	Nuk ka vetëlëvizje

Ka ndjeshmëri	Nuk ka ndjeshmëri

GABIMET në %				
	PËRQINDJA E RRYMËS NOMINALE			
	10	20	50	100
Cos φ = 1				
Cos φ = 0.5				
Sin φ = 1				
Sin φ = 0.5				

Matësi u soll brenda klasës së saktësisë	
MATËSI U VULOS ME VULËN NR.	

Ky aktkontroll mbahet në tri kopje ku një kopje mbetet në laborator dhe dy i jepen atij që solli matësin.

AKTINSTALIMI

I mbajtur sot më datë _____ në laboratorin e kontrollit dhe kolaudimit të matësve të Drejtorisë Zonale Tiranë në prani të:

1. _____
2. _____
3. _____

Për sa më poshtë vijon:

z. _____ solli në laborator matësin:

1. Njëfazor Trefazor aktiv Trefazor reaktiv
2. Tipi _____
3. Nr. i serie _____
4. Rryma _____ A
5. Tensioni _____ V
6. Nr. i rrotullimeve (Impul) për _____ kWh, kVArh
7. Gjendja e leximit _____
8. Numri i vulës së makinerisë _____
9. Nr. i raportit teknik (punës) _____

Pasi u vendos në sende dhe u kontrollua rezultoi:

1. Vetëlevizje: nuk ka ka
2. Ndjeshmëri: nuk ka ka
3. Gabimi në % rezultoi: _____

	Përqindja e rrymës nominale			
	10%	20%	50%	100%
Cos0=1				
Cos0=0.5				

4. Ndërrhyrje në matës: nuk ka ka Përgjegjësia _____
5. Djegia për efekt mbingarkese: nuk ka , ka Përgjegjësia _____
6. Matësi u soll brenda klasës së saktësisë _____
7. Matësi u vulos më vulën nr. _____

Aktkonstatimi mbahet në 5 (pesë) kopje prej të cilave:

- Një kopje qëndron në laborator;
- Një kopje i jepet repartit të menaxhim-matjes;
- Një kopje i jepet repartit të asistencës teknike;
- Një kopje i jepet elektrikistit që solli matësin;
- Një kopje dërgohet pranë drejtorisë zonale.

Aktkonstatimi pasi lexohet firmoset: 1. _____ 2. _____

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë _____ në laboratorin e kontrollit të matësve të zonës elektrike shpërndarëse Tiranë në prani të z.

1. _____
2. _____
3. _____

Punonjës të laboratorit nga njëra anë dhe:

z. _____

Nga ana tjetër për sa më poshtë:

z. _____ solli në laborator:

Matësin 1. Njëfazor Trefazor aktiv (reaktiv)

2. Tipi _____

3. Nr. serie _____

4. Rryma _____ A

5. Tensioni _____ V

6. Nr. i rrotullimeve (Impul) për _____ kWh, kVARh

7. Gjendja e leximit _____

8. Nr. i vulës së makinerisë _____

9. Nr. i raportit teknik (punës) _____

Nga kontrolli me sy në prani të të dyja palëve u konstatua:

Procesverbali mbahet në 5 (pesë) kopje prej të cilave:

- Një kopje qëndron në laborator;
- Një kopje i jepet repartit të menaxhim-matjes;
- Një kopje i jepet repartit të asistencës teknike;
- Një kopje i jepet elektrikistit që solli matësin;
- Një kopje dërgohet pranë drejtorisë zonale.

Specialisti që solli matësin:

Për laboratorin:

1. _____
2. _____
3. _____

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 24.8.2011
Doli nga shtypi më 24.8.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 34 lekë